



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic Prosecution
Autoriteti Kompetent

AD.nr.17/2024

Datë: 08.01.2025

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të palëve G.S. dhe N.S., e parashtruar përmes të autorizuarve të tyre av.F.Sh., av.B.A.. dhe av.S.K, kundër N.S., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 08.01.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore kundër N.S., Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.4, 2.5 dhe 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 10.12.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, nga ana e palëve G.S. dhe N.S., e përmes të autorizuarve të tyre av.F.Sh., av.B.A.. dhe av.S.K, ka pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore kundër prokurores N.S., e cila ka qenë në trajtim të lëndës penale PP/II.nr....., në të cilën çështje penale parashtruesit e kësaj kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore kanë cilësinë e palëve të dëmtuara, e të cilët pretendojnë se prokurorja N.S. duke shfrytëzuar pozitën e saj si prokurore e rastit nuk e ka kryer punën zyrtare në mënyrën e përcaktuar me ligj, me pretendimet se e njëjta ka shkelur ligjin me rastin e marrjes së aktvendimit për pushimin e hetimeve të dt.18.09.2024, duke e mbështetur vendimin për pushim të hetimeve mbi provën-zarfin e pranuar në mënyrë private në kundërshtim me ligjin, me pretendimet se prokurorja e çështjes kishte selektuar shkresat dhe provat kryesore i kishte fshehur, meqë të njëjtat nuk i kishte përmendur në aktvendim për pushim të hetimeve, ndërkaq të njëjtat ia kishte dhënë të autorizuarve të palëve të dëmtuara vetëm pasi që këta të fundit e kishin njoftuar prokuroren se janë në dijeni për provën – përgjigjen e ILECU-t –e cila sipas të dëmtuarve paraqet provën kryesore e cila i inkriminon të pandehurit në kryerjen e veprave penale, e të cilën të njëjtit pretendojnë se prokurorja N.S. ka tentuar ta fshehtë dhe të mos ju dorëzojë palëve të dëmtuara, me pretendimin se prokurorja N.S. me rastin e arrestimit të të pandehurit A.G., dhe përpilimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, nuk kishte

paraqitur në gjykatë faktin se të njëjtit në shtëpi i ishte gjetur një sasi e madhe e armatimit, pretendimet se prokurorja N.S. nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim karshi njoftimit të gjyqtarës E.Q. për bashkim të lëndëve për të pandehurin Y.H dhe A.G. të cilët kishin vepruar në bashkëkryerje, me pretendimet se prokurorja N.S. kishte ndërprerë arrestin shtëpiak të dyshuarit A.G. edhe pse i njëjti ishte mbrojtur në heshtje në polici dhe prokurori dhe edhe pse prokurorja nuk kishte kryer hetimet, pra nuk kishte pushuar rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i ndikimit në prova dhe dëshmitarë, marrë për bazë faktin edhe se i njëjti është recidivist, me pretendimet se prokurorja N.S. ka raporte të ngushta shoqërore me bashkëshorten e të dyshuarit A.G., M.G dhe me noterën që e ka noterizuar dokumentin Resenje broj për dy të dyshuarit Y.H dhe A.G., ku të njëjtës prokurorja e çështjes i kishte bërë koment në një foto në rrjetin social FACEBOOK, me pretendimet se prokurorja N.S. i kishte dhënë premtimin të pandehurit A.G. gjatë marrjes në pyetje në prokurori se nëse ai sjell një histori, prokurorja në fjalë do e shfrytëzoj pozitën e saj që t'i mbyllë hetimet në mënyrë të kundërligjshme, prokurorja nuk kishte vepruar për të kërkuar sekuestrimin-urdrin ndalues përfundimtar për 7 parcela por vetëm për një parcelë, duke ju sjellë dobi pasurore të dyshuarve, me pretendimet se prokurorja në fjalë ka shkelur detyrat e saj zyrtare duke komunikuar me personat e paaautorizuar informacionin konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ashtu që ia kishte komunikuar informacionet konfidenciale lidhur me lëndën në hetim dhe atë të pandehurit A.G., duke i vënë në dispozicion edhe shkresa lidhur me lëndën për të cilën i njëjti ishte duke u hetuar, me pretendimet se prokurorja e çështjes ka bërë shkelje pothuajse në çdo veprim të saj lidhur me këtë çështje duke ndërmarrë veprime të cilat shkojnë në favor të të dyshuarit, e që nga të theksuara si në kërkesë paraqitësit e kësaj kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pretendojnë se ekziston baza ligjore e kësaj kërkesë, konform nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.4, 2.5 dhe 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Kërkesa e njëjtë për iniciimin e procedurës disiplinore nga palët e dëmtuara G.S. dhe N.S. ishte dorëzuar edhe pranë Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe e cila pastaj më dt. 17.12.2024 ishte deleguar te ne për të vendosur si Autoritet Kompetent.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e hetimeve disiplinore ndaj Prokurores N.S..

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Me datë 10.12.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nën numrin AD.nr.17/2024.

Me datë 11.12.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe regjistrimin e saj.

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 10.12.2024, kemi pranuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nga ana e palëve G.S. dhe N.S., e përmes të autorizuarve të tyre av.F.Sh., av.B.A.. dhe av.S.K, kundër prokurores N.S., e cila ka qenë në trajtim të lëndës PP/II.nr...., në të cilën çështje penale parashtuesit e kësaj kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore kanë cilësinë e palëve të dëmtuara, e të cilët pretendojnë se prokurorja N.S. duke shfrytëzuar pozitën e saj si prokurore e rastit nuk e ka kryer punën zyrtare në mënyrën e përcaktuar me ligj, me pretendimet se e njëjta ka shkelur ligjin me rastin e marrjes së aktvendimit për pushimin e hetimeve të dt.18.09.2024, duke e mbështetur vendimin për

pushim të hetimeve mbi provën-zarfin e pranuar në mënyrë private në kundërshtim me ligjin, me pretendimet se prokurorja e çështjes kishte selektuar shkresat dhe provat kryesore i kishte fshehur, meqë të njëjtat nuk i kishte përmendur në aktvendim për pushim të hetimeve, ndërkaq të njëjtat ia kishte dhënë të autorizuarve të palëve të dëmtuara vetëm pasi që këta të fundit e kishin njoftuar prokuroren se janë në dijeni për provën – përgjigjen e ILECU-t – e cila sipas të dëmtuarve paraqet provën kryesore e cila i inkriminon të pandehurit në kryerjen e veprave penale, e të cilën të njëjtit pretendojnë se prokurorja N.S. ka tentuar ta fshehtë dhe të mos ju dorëzoj palëve të dëmtuara, me pretendimin se prokurorja N.S. me rastin e arrestimit të të pandehurit A.G., dhe përpilimit të kërkesës për caktimin e paraburgimit, nuk kishte paraqitur në gjykatë faktin se të njëjtit në shtëpi i ishte gjetur një sasi e madhe e armatimit, pretendimet se prokurorja N.S. nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim karshi njoftimit të gjyqtarës E.Q. për bashkim të lëndëve për të pandehurin Y.H dhe A.G. të cilët kishin vepruar në bashkëkryerje, me pretendimet se prokurorja N.S. kishte ndërprerë arrestin shtëpiak të dyshuarit A.G. edhe pse i njëjti ishte mbrojtur në heshtje në polici dhe prokurori dhe edhe pse prokurorja nuk kishte kryer hetimet, pra nuk kishte pushuar rreziku i përsëritjes së veprës penale, rreziku i ndikimit në prova dhe dëshmitarë, marrë për bazë faktin edhe se i njëjti është recidivist, me pretendimet se prokurorja N.S. ka raporte të ngushta shoqërore me bashkëshorten e të dyshuarit A.G., M.G dhe me noteren që e ka noterizuar dokumentin Resenje broj për dy të dyshuarit Y.H dhe A.G., ku të njëjtës prokurorja e çështjes i kishte bërë koment në një foto në rrjetin social FACEBOOK, me pretendimet se prokurorja N.S. i kishte dhënë premtimin të pandehurit A.G. gjatë marrjes në pyetje në prokurori se nëse ai sjell një historiat, prokurorja në fjalë do e shfrytëzoj pozitën e saj që t'i mbyllë hetimet në mënyrë të kundërligjshme, prokurorja nuk kishte vepruar për të kërkuar sekuestrimin-urdhrin ndalues përfundimtar për 7 parcela por vetëm për një parcelë, duke ju sjellë dobi pasurore të dyshuarve, me pretendimet se prokurorja në fjalë ka shkelur detyrat e saj zyrtare duke komunikuar me personat e paautorizuar informacionin konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ashtu që ia kishte komunikuar informacionet konfidenciale lidhur me lëndën në hetim dhe atë të pandehurit A.G., duke i vënë në dispozicion edhe shkresa lidhur me lëndën për të cilën i njëjti ishte duke u hetuar, me pretendimet se prokurorja e çështjes ka bërë shkelje pothuajse në çdo veprim të saj lidhur me këtë çështje duke ndërmarrë veprime të cilat shkojnë në favor të të dyshuarit, e që nga të theksuara si në kërkesë paraqitësit e kësaj kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore pretendojnë se ekziston baza ligjore e kësaj kërkesë, konform nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.4, 2.5 dhe 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurores N.S. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP/II.nr.....

Deklarimet e Prokurores N.S. në raportin me shkrim të dorëzuar më datë 18.12.2024

Prokurorja N.S., në raportin e saj me shkrim të dorëzuar në zyrën e Kryeprokurorit më datë 18.12.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: *“Duke u bazuar në njoftimin e datës 11.12.2024, me nr. AD.nr.17/2024, të cilin e kam pranuar po me këtë datë, përmes emailit zyrtar, me ç'rast keni kërkuar që të siguroj një raport lidhur me ecurinë e rastit me nr.PP.II..... Paraprakisht siç jeni në dijeni edhe*

ju, me dt. 26.11.2021 pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, është paraqitur kallëzimi penal nga ankuesit N.S. dhe G.S., kundër të dyshuarve Y.H, Sh.B., B.B., Q.H, personave përgjegjës të Komunës së Prishtinës-Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, në drejtim të veprave penale Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve, nga neni 283 par 2 dhe par 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në drejtim të veprave penale Legalizimi i Përmbajtjes së Rreme nga neni, 395 par 1 dhe par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe në drejtim të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 lidhur me par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ky kallëzim penal fillimisht është regjistruar me nr. PPN/I.nr..... në Departamentin e Krimeve të Rënda, prokurorja e rastit pas ndërmarrjes së disa veprimeve hetimore me një akt përcjellës me shkrim me dt. 04.10.2022, ka dorëzuar në kompetencë lëndore të gjitha shkresat e lëndës me 4-5 folldera ,që sipas vlerësimit e njëjta ka konstatuar se në rastin konkret ekziston dyshimi i arsyeshëm se i dyshuari Y.H, e ka kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 të KPRK-së. Sipas programit Smil, e njëjta lëndë më është ndarë mua si Prokurore e Shtetit pranë Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm që të trajtoj më tutje rastin në fjalë duke u regjistruar me numrin rendor penal PP.II.nr....., me të cilën jam ngarkuar në zyrën time me datë 20.10.2022. Menjëherë pasi që lëndën e kanë sjellë në zyrën time, pas analizimit të kallëzimit penal dhe shkresave tjera të lëndës kam vërejtur se prokurorja paraprake nuk ka ndërmarr ndonjë veprim për hedhjen e kallëzimit penal lidhur me personat e lartcekur të paraqitur si në kallëzimin penal. Atëherë siç e dini edhe ju, unë kam kërkuar një takim me Ish Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë zt.K.M. që të bisedojmë lidhur me rastin në fjalë dhe atë në zyrën e tij ku keni qenë i pranishëm edhe ju z. Z.G. në cilësi të Udhëheqësit në Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, ku gjatë takimit që kemi realizuar unë si Prokurore jam munduar që të sqarohem se unë në atë kohë nuk kam pasur mundësi ligjore të ndërmarr ndonjë veprim hetimor pa i përfunduar veprimet paraprake nga Prokurorja e Krimeve të Rënda. Me datë 12.10.2022, Kryeprokurorit të atëhershëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë zt.K.M., i kam paraqitur kërkesë për caktimin e kompetencës lëndore, pasi që pas vlerësimit të rastit kam vërejtur se në shkresat e lëndës nuk është bashkangjitur ndonjë vendim apo shënim zyrtar i ndërmarr nga prokurori i Departamentit të Krimeve të Rënda, lidhur me veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 dhe par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Pas kësaj kërkesë, Ish Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë zt.K.M., me dt. 12.10.2022, ka marrë Vendimin me nr.PPN.I..... dhe ka vendosur që prokurorja B.Gj, si prokurore e Krimeve të Rënda të caktohet si kompetente të trajtoj lëndën e evidentuar me numër të lartcekur.

Prokurorja e rastit të Departamentit të Krimeve të Rënda, me dt. 14.10.2022 , me anë një shkrese e ka përcjellë përsëri komplet lëndën në zyrën time, nën vlerësimin e saj se pas analizimit të lëndës me asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i arsyeshëm se personat përgjegjës të Komunës së Prishtinës për Gjeodezi dhe Kadastër janë të dyshuar për veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par 1 dhe 2 lidhur me par 2 dhe veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par 1 dhe par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me arsyetimin se nuk është në kompetencë të Departamentit të Krimeve të Rënda të marr Aktvendim për fillimin e hetimeve sepse me asnjë provë nuk është vërtetuar dyshimi i arsyeshëm se është kryer ndonjë vepër penale e cila do të binte në kompetencën e këtij departamenti, më tutje sipas prokurores së çështjes sa i përket kërkesës për masë të përkohshme të sigurimit, prokurorja ka vlerësuar se nuk është në kompetencë të Departamentit të Krimeve të Rënda. Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 26.10.2022, nga ankuesit N.S. dhe G.S, të përfaqësuar nga avokatet e tyre S.K-S, B.A., dhe F.Sh., ka pranuar kallëzimin penal shtesë-plotësues, të paraqitur kundër të dyshuarit Y.H, në drejtim të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395

par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mashtrimi sipas nenit 323 par. 4 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me dt. 27.10.2022, ka filluar Hetimet kundër të pandehurit Y.H, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mashtrimi sipas nenit 323 par. 4 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore në rastin konkret, me dt. 27.10.2022, me shkrim kam autorizuar P.K DHKEK-DPP-Prishtinë, hetuesin –rreshterin I.G, që të ndërmarrin veprime hetimore dhe atë Urgjentisht të ftohet i pandehuri Y.H me qëllim të intervistimit të njëjtit në drejtim të veprave penale për të cilat dyshohet, gjeësisht nga i njëjti kam kërkuar që i dyshuari në fjalë të pyetet se a posedon dokumentin “ RESHENJE”,...” 15 JUNA 1961 ,BROJ të dt. 7.VIII.1961, dhe është udhëzuar që i njëjti dokument origjinal të dorëzohet në zyrën e Prokurorit të shtetit me qëllim të ekzaminimit të të njëjtit në Agjencinë Forenzike të Kosovës, krejt kjo me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje penale. Hetuesi i rastit, duke vepruar sipas autorizimit të prokurorit, me dt.07.11.2022, me shkrim ka raportuar lidhur me veprimet e ndërmarra, ashtu që sipas policisë të njëjtit kanë provuar që ta kontaktojnë të pandehurin Y.H përmes telefonit të tij mirëpo nuk kanë arritur, që nga familjarët nuk e ka hapur derën e banesës, policia përsëri ka kontaktuar avokatin e e tij V.V. dhe sipas të njëjtit të bisedojnë me të pasi që ka qenë i pa qasshëm, më pas policia kishte shkuar në banesën ku ka banuar i pandehuri dhe nga aty janë informuar se i pandehuri Y.H gjendet jashtë shtetit pasi që ka udhëtuar për në shtetin e Hungarisë. Policia ka vepruar tutje duke verifikuar data bazën e policisë dhe kanë arritur të gjejnë të dhënat se personi i lartcekur i cili me dt. 05.10.2022 në ora 16:13 minuta ka dalur në vendkalimin kufitar në Merdare me pasaportën e tij me nr.P.... Me dt.07.11.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin e Përgjithshëm, Gjyqtarit të procedurës paraprake i kam paraqitur kërkesë për dhënien e Urdhërarrestit për të pandehurin Y.H, pasi që PTHP - Departamenti i Përgjithshëm pas analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se i pandehuri gjatë fazës së hetimeve i është shmangur ftësive të policisë për intervistim dhe gjendet në arrati sot e kësaj dite. Edhe pas shumë përpjekjeje nga ana e policisë për tu intervistuar nuk është paraqitur për të dhënë sqarime lidhur me veprat penale për të cilat dyshohet. Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e procedurës paraprake E.Q., me dt. 14.11.2022 ka lëshuar URDHËRARREST, kundër të pandehurit Y.H. Kam vazhduar me veprimet hetimore ashtu që me dt. 07.12.2022, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm kam paraqitur kërkesën për lëshimin e Urdhrit për sekuestrimin e përkohshëm të pronës së paluajtshme me te dhënat si me poshtë te paraqitura: Për parcelën me bashkimin e parcelave tani figuron ngastra kadastrale me sipërfaqe prej ...m2, e cila gjendet në vendin e quajtur “Veternik” në Prishtinë, për shkak të dyshimit të bazuar se e njëjta është përfutur me kryerjen e veprave penale nga i pandehuri Y.H të cekur si në Aktvendim për fillimin e hetimeve. Duke vepruar sipas kësaj kërkesë gjyqtarja e procedurës paraprake E.Q. me dt. 18.11.2022 ka lëshuar Urdhëresë për sekuestrimin e përkohshëm për pronën e lartcekur. Gjykata Themelore në Prishtinë, kolegji i përbërë nga gjyqtaret A.SH-R, kryetare e kolegjit, M.B. dhe S.S. anëtar duke vendosur lidhur me kundërshtimin e ushtruar nga mbrojtësi i palës së interesuar-subjektit juridik ... shpk, av. V.H., të parashtruar kundër urdhrit për sekuestrim të përkohshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm me nr. PN. Nr. ... të datës 18.12.2022, në seancën e kolegjit 07.12.2022, ka marr aktvendim në të cilën ka aprovuar kundërshtimin e palës së tretë av. V.H. dhe ka anuluar urdhrin për sekuestrim të përkohshëm të kësaj Gjykate PN.Nr... të datës 18.12.2022, dhe çështja i është kthyer Gjyqtarit të procedurës paraprake në rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e procedurës paraprake E.Q. me numër të lëndës PN.nr..... me datë 08.12.2022 ka paraqitur kërkesë pranë Prokurorisë Themelore Prishtinë që të plotësohet kërkesa për lëshimin e urdhrit për Sekuestrim të Përkohshëm me numër të rastit të datës 09.12.2022 në kuptim të nenit 112 par. 3 të KPPRK-së. Prokuroria Themelore Prishtinë, me numër të rastit PP.II.nr. të datës 09.12.2022 në kuptim të nenit 112 par. 3 të KPPRK-së, duke

vendosur sipas kërkesës së Gjykatës, ka plotësuar kërkesën për lëshimin e urdhrit për sekuestrim të përkohshëm dhe e njëjta është dërguar në Gjykatë. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e procedurës paraprake E.Q., me numër PN.nr... me datë 20.12.2022, me aktvendim ka refuzuar kërkesën për sekuestrimin e pronës së paluajtshme e plotësuar me datën 09.12.2022 ndaj të dyshuarit Y.H. Unë si Prokurore e çështjes lidhur me rastin në fjalë kundër këtij aktvendimi pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, Kolegjit Shqyrtues të kësaj Gjykate me datë 05.01.2023 kam ushtruar kundërshtim për shkak të shkeljes procedurale që ka për qëllim garantimin e së drejtës nga neni paragrafi 1.1 deri te 1.3 të nenit 415 të KPK-së. Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm me numër PN..., në Kolegjin e përberë nga Gjyqtarët K.G-L si Kryetare e Kolegjit, F.O dhe S.Ç si anëtar duke vendosur me kundërshtimin-ankesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si dhe ankesës së përfaqësuesve të autorizuar të palëve të dëmtuara G.S. dhe N.S., avokat B.A., av.S.K-S dhe av.F.Sh. të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PN.... të datës 20.12.2022, në seancën e mbajtur me 06.02.2023 ka aprovuar këto ankesa të parashtruara dhe më të cilën ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PN.... të datës 20.12.2022 dhe lënda i është kthyer Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja e procedurës paraprake E.Q., me numër PN.nr.. me datë 23.03.2023 ka lëshuar aktvendim më të cilin përsëri e ka refuzuar kërkesën për sekuestrimin e pronës së paluajtshme të cekur si më lart. Prokuroria Themelore në Prishtinë, unë si prokurore e çështjes me numër të rastit PP.II.nr.. me datë 30.03.2023 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, duke u bazuar në dispozitat ligjore, brenda afatit ligjor kam ushtruar ankesë për shkak të: 1.Shkeljes se drejtës procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga nën-paragrafët 1.1 deri 1.3 të nenit 415 të KPP-së; 2.Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par 2 nën par 2.1 lidhur me nenin 112 par 6 të KPP-së; 3. Mos respektimi i vërejtjeve të Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit e Kosovës, në kolegjin e përberë nga Gjyqtarët S.Ç – kryetar, F.O dhe A.A anëtar, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit si dhe ankesën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve të dëmtuara G.S. dhe N.S., avokat B.A., av.S.K.S dhe av. F.Sh. të ushtruara kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm PN... të datës 23.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 14.04.2023 ka marr aktvendim më ç'rast ka anuluar përsëri aktvendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës me numër ... të datës 23.03.2023 dhe lënda i është kthyer Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje, duke vlerësuar se pas analizimit të shkresave të lëndës dhe aktvendimit të ankimuar me ç'rast e njëjta ka rekomanduar që në rastin konkret është dashur të zbatohen dispozitat e KPPK-së që tani janë në fuqi, ashtu që sipas nenit 259 deri te neni 269 të KPPK –së (Kodi nr.08/L-0320) në bazë të cilës janë përcaktuar veprimet procedurale të cilat duhet të ndërmerren me rastin e vendosjes për sekuestrimin e përkohshëm të pronës së paluajtshme nëse prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se pasuria e sekuestruar përkohësisht mund ti nënshtrohet konfiskimit, i njëjti mund të lëshoj urdhër ndalimi të përkohshëm me të cilin ia ndalon çdo personi të cekur në urdhër që të ndërmerr ndonjë veprim në lidhje me pasurinë e specifikuar në urdhër i cili mund të kishte vendosur në urdhër, i cili mund të kishte vendosur lidhur me ndonjërin masë nga neni 260 të KPPK-së, dhe një urdhër i këtillë do të kishte efekte 7 (shtatë) ditë, derisa prokurori i shtetit të ketë paraqitur kërkesë për urdhër ndalimi përfundimtar, urdhri ndalues i përkohshëm do të mbetet i vlefshëm derisa gjykata të ketë vendosur mbi kërkesën për urdhrin ndalues përfundimtar. Me dt. 15.05.2023 Gjyqtarja e Procedurës paraprake E.Q., me një akt përcjellës ka përcjell Aktvendimin e gjykatës së Apelit me nr. të referencës PN.. të dt.14.04.2023, duke kërkuar që të veprohet sipas sugjerimeve të kolegjit të gjykatës së Apelit. Unë si prokurore e çështjes duke vepruar sipas sugjerimeve të kolegjit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër të referencës PN....., të dt. 23.03.2023, kam vepruar ashtu që në përputhje me nenin 7, 48 lidhur me zbatimin e nenit 260 par. 4 lidhur me par. 3 të KPPK-së, brenda afatit ligjor kam lëshuar URDHËR TË PËRKOHSHËM TË NDALIMIT, në lëndën

penale kundër të pandehurit Y.H, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme, sipas nenit 393 par 4 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mashtrimi, nga neni 323 par 4 lidhur me paragrafi 1, lidhur me nenin 77 të KPP-së. Ndërsa po ashtu në mbështetje të nenit 7, 48 lidhur me zbatimin e nenit 261 par 2 dhe 3 dhe nenin 262 par 1 KPP-se, brenda afatit ligjor me dt.26.05.2023 kam parashtruar kërkesë për urdhër ndalues përfundimtar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm.

Lidhur me rastin në fjalë, me qëllim të sigurimit të provave në këtë çështje penalo juridike, me dt.27.01.2023 kam parashtruar Kërkesë për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës që e njëjta kërkesën e Prokurorisë ta përcjell tek organi Përgjegjës Qendror Kadastral i Republikës së Serbisë, që të sigurohen të dhëna dokumentacioni nëse gjendet në arkiva historiati i parcelës ... Zona Kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej ... ha në vendin e quajtur Veternik Prishtinë, në veçanti është kërkuar që të sigurohet vendimi (Reshenje) me nr.BROJ ... të dt.7.VIII.1961 i lëshuar nga organi kompetent I Këshillit Popullor i Komunës së Prishtinës. Me dt. 30.01.2023 kam paraqitur kërkesë urgjente për sigurimin e provës Komunës së Prishtinës-Drejtorisë së Kadastrit, ndërsa me dt. 31.01.2023 kam ndërmarr veprime hetimore ashtu që me të njëjtën datë me shkrim kam autorizuar Urgjentisht P.K DHKEK-DPP-Prishtinë hetuesin –rreshterin I.G, që të ndërmarrin veprime hetimore shtesë (të gjitha detajet brenda shkresave të lëndës).

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm lidhur me çështjen në fjalë përsëri, me datë 18.03.2024 ka autorizuar Policinë e Kosovës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë DHKEK –DPP- Prishtinë që të njëjtit të ndërmarrin veprime hetimore shtesë edhe një herë përmes rrugëve diplomatike të kërkohej përmes institucioneve adekuate të autoriteteve Serbe gjegjësisht Drejtorisë së Kadastrit të Serbisë lidhur me historiatin e pronës dhe verifikimin e vendimit me nr. të lëndës nr. ... dhe të dhënat tjera lëshuar për parcelën e me nr.... që gjendet në Veternik - Prishtinë. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë DHKEK–DPP- Prishtinë, me datë 28.05.2024 jam njoftuar se me datë 23.05.2024 të njëjtit kanë pranuar përgjigje nga drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit ILECU, lidhur me veprimet hetimore të kërkuara sipas kërkesës së Policisë me nr. DHKEK/P/.... me ç'rast Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit – ILECU ka njoftuar hetuesin e rastit se të njëjtit kanë pranuar një njoftim nga autoritetet serbe me nr. të rastit .. të datës 21.05.2024 të dërguar përmes email adresës ... lidhur me kërkesën me nr. reference DHKEK/P..., ku thuhet se autoritetet relevante në Ministrinë e Brendshme të Serbisë kanë bërë kërkimet e nevojshme dhe kanë konstatuar se në arkivat e tyre nuk posedojnë dokumente të kërkuara nga Policia e Kosovës e gjithë kjo në kundërshtim me pretendimet e Avokates S.K –S (të gjitha detajet brenda shkresave të lëndës dhe të dërguara përmes email-it zyrtar nga Zyra e Prokurores me datë 01.10.2024).

Lidhur me rastin në fjalë me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje penalo-juridike, prokuroria ka bërë shumë veprime hetimore dhe kërkesa në të gjitha institucionet e shtetit të Kosovës dhe Arkivat për të siguruar në origjinal dokumentin Aktvendimin (Reshenje) me nr.BROJ të dt. 7.VIII.1961, i cili dyshohej se ishte i falsifikuar dhe dyshohej se të pandehurit Y.H në bashkëkryerje edhe me të pandehurin A.G., me qëllim të vënies në lajthim të organit kompetent dhe me qëllim të vërtetimit të një çështje si të vërtetë, kanë përdorur dokumentin e dyshuar si i falsifikuar “reshenje broj të datës 07.VIII.1961”, duke vënë në lajthim organet shtetërore edhe pse kanë qenë në dijeni se nuk është i tillë, duke filluar nga zyra e noterëve deri në gjykatë , kështu kanë

arritur që i pandehuri Y.H të bëhet trashëgimtar i pronës në lagjen "Veternik" në Prishtinë, në parcelën e evidentuar me nr.Prishtinë, përmes aktvendimit plotësues për trashëgimi, i regjistruar me LRP dhe ref....., me te cilin trashëgimia behet në emrin e trashëgimtarit te vetëm ligjor Y.H, për çka në këtë drejtim janë filluar hetimet kundër të pandehurve A.G. dhe Y.H në drejtim të veprave penale Legalizim i përmbajtjes se rreme nga nenin 395 par.2 lidhur me nenin 31 KPRK-se, si dhe veprën penale Mashtrimi, nga neni 232 par. 4 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, në këtë çështje penalo juridike me qëllim të sigurimit të provave gjegjësisht dokumentit të dyshuar si i falsifikuar Aktvendimin (Reshenje) me nr.BROJ të dt. 7.VIII.1961, me dt.27.01.2023, ka parashtruar Kërkesë për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare në Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës që të njëjtën kërkesë të Prokurorisë ta përcjell tek organi Përgjegjës Qendror Kadastral i Republikës së Serbisë, që të sigurohen të dhënat dokumentacioni nëse gjendet në arkivat e tyre historiat i parcelës ... Zona Kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe prej ... ha, në vendin e quajtur Veternik Prishtinë, në veçanti është kërkuar që të sigurohet vendimi (Reshenje) me nr.BROJ ... të dt. 7.VIII.1961 i lëshuar nga organi kompetent Këshilli Popullor i Komunës së Prishtinës.

Prokuroria Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm me dt.19.07.2024, përmes postës DHL –DHL Express, ka pranuar dokumentacioni në pliko të mbyllur ngjyrë të verdhë, fillimisht e dërguar në zyrën tuaj si Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ku është bashkangjitur i gjithë historiat dokumentacioni i parcelës Zona Kadastrale Prishtinë, në vendin e quajtur Veternik Prishtinë, i kërkuar përmes rrugëve diplomatike, Ndihmës Juridike Ministrisë së Drejtësisë, e i dërguar nga: REPUBLIKA E SERBISË ENTI GJEODEZIK REPUBLIKAN SEKTORI PËR MBIKËQYRJE DHE INSPEKTIM PROFESIONAL DEPARTAMENTI I ARKIVËS - SHËRBIMI PËR KADASTËR TË PALUAJTSHMËRISË PRISHTINË 38000 Prishtinë, Data: 10.06.2024 Bulevardi Vojvoda Mishiç 39 Beograd058/-4/2024-3975 SHËRBIMI PËR KADASTËR TË PALUAJTSHMËRISË PRISHTINË 38000 Prishtinë.

Ndërkaq, në vlerësim të nenit 7, paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, Prokuroria Themelore Prishtinë – Departamenti I Përgjithshëm vlerëson se provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës e sidomos provat e siguruara përmes Ndihmës Juridike Ndërkombëtare - Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës, me kërkesën me nr. të Prokurorisë Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, në lidhje me ngastrën ... ZK Prishtinë me sipërfaqe ... ha në vendin e quajtur Veternik, të siguruar në rrugë diplomatike Departamenti i Arkivës së Entit Gjeodezik Republikan (EGJR), organi kompetent për kadastër i Republikës së Serbisë në Beograd- departamenti për libra tokësore për Prishtinë ka gjetur dokumentacionin e kërkuar andaj, për siguri ka njoftuar që ekziston dokumentacioni i kërkuar nga Prokuroria me ç'rast të njëjtit kanë bashkëngjitur edhe kopjet e originalit që gjenden në shkresa të lëndës dhe të përkthyerat më vonë në Prokurori, andaj në rastin konkret mungojnë elementet qenësore që përbëjnë figurën e veprës penale Legalizim i përmbajtjes se rreme nga nenin 395 par.2 lidhur me nenin 31 KPRK-së, si dhe veprën penale Mashtrimi, nga neni 232 par. 4 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe në këtë rast me datë me datë 19.09.2024, në bazë të nenit 158 par.1.1 KPPK-së kam marr Aktvendim për Pushimin e Hetimeve kundër të pandehurit Y.H.

Në këtë drejtim, me datë 04.10.2024 me anë të Aktit Përcjellës në Prokurorinë e Apelit është përcjellë Ankesa e palëve G.S. dhe N.S. përfaqësuar nga Avokatja S.K Sadiku, me ç'rast siç jeni në dijeni edhe ju, nga Prokuroria e Apelit me datë 17.10.2024 është pranuar Aktvendimi mbi aprovimin e tërësishëm të ankesës së palëve në fjalë. Me datë 18.10.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë pranë Gjykatës Themelore Prishtinë ka parashtruar Aktvendim për Rifillimin e Pushuar të Hetimeve dhe po të njëjtën datë nga Gjykata Themelore Prishtinë ka kërkuar vazhdimin e afatit të Hetimeve lidhur me lëndën PP.II.nr. dhe me datë 24.10.2024 nga Gjykata Themelore Prishtinë kemi pranuar Aktvendimin me nr. PPR.nr..... – Lejohet afati shtesë i Hetimeve edhe për një vit deri me datën 27.10.2025 kundër të pandehurit Y.H.

Gjatë gjithë procesit hetimor, palët G. dhe N.S. dhe avokatët e tyre të autorizuar av.S.K -S, Av. B.A.. dhe Av. F.Sh. sipas kërkesave tyre zyrtare janë njoftuar lidhur me informatat të cilëve iu është besuar me dispozita ligjore në këtë drejtim për të cilat në shkresa të lëndës janë të evidentuara të gjitha dëshmitë e bashkangjitura si në vijim: me datë 31.01.2024 Parashtrësë – Kërkesë Urgjente për qasje në shkresa të lëndës nga Avokatja S.K-S e cila me datë 01.02.2024 e njëjta ka nënshkruar fletkthesën e PTHP e cila ka konfirmuar pajisjen me shkresa të lëndës; me datë 01.03.2024 Avokatja S.K-S ka parashtruar kërkesë pranë Prokurorisë për pajisjen me përgjigje nga Arkivi Komunal, kopjen e kërkesës për ekspertizë grafologjike dhe deklaratën e noteres V.A. e cila me datë 04.03.2024 ka nënshkruar fletkthesën e PTHP e cila ka konfirmuar pajisjen me dëshmi të kërkuara; me datë 27.09.2024 Avokatja S.K ka parashtruar sërish kërkesë pranë Prokurorisë për pajisjen me shkresa të lëndës të cilës me datë 30.09.2024 i janë siguruar dhe dorëzuar shtatë folldera me të gjitha shkresat e lëndës e njëjta ka nënshkruar flet kthesën e PTHP-së; me datë 01.10.2024 Avokatja S.K S përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar kërkesë sërish për pajisjen e dokumentit saktësisht Kërkesës për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare Drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës dhe përgjigjen e të pranuar nga ILECU të cilës i janë dërguar komplet shkresat e kërkuara ku kanë qenë në mesin e tyre edhe deklarata e S.H. (dëshmi email zyrtar me dokumentacion te skanuar]. Pas kërkesës së vazhdueshme të avokates S.K përmes emailit zyrtar, të njëjtës ju kam përgjigjur me shkrim përmes emailit, duke ju përgjigjur se për hir të korrektësisë së edukatës time po e përsërisë edhe njëherë se të gjitha shkresat e lëndës me numër PP/II.nr...., për momentin nuk gjenden në zyrën time, ndërsa sa i përket pretendimeve tuaja se unë kam fshehur ndonjë shkresë që ka pasur të bëjë me rastin lidhur me fillimin e hetimeve të dt. 27.10.2022, kundër të pandehurit Y.H, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mashtrimi sipas nenit 323 par 4 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-s, kjo nuk qëndron pasi që unë nuk kam pranuar ndonjë raport përfundimtar të policisë në zyrën time nga hetuesit e rastit përveç raporteve informuese lidhur me autorizimet paraprake të bëra nga ana ime, e të cilat gjenden të bashkangjitura të gjitha në shkresa të lëndës.

Ndërsa sa i përket pretendimeve se ju nuk jeni pajisur me shkresa të lëndës edhe kjo nuk qëndron pasi sipas kërkesës tuaj po ju përkujtoj se sipas zyrtarit ligjor në zyrën time ju me datë 31.01.2024 keni parashtruar parashtrësë – Kërkesë Urgjente për qasje në shkresa të lëndës me ç'rast me datë 01.02.2024 keni pranuar dhe nënshkruar fletkthesën e PTHP ku edhe keni konfirmuar pajisjen me shkresa të lëndës, me datë 01.03.2024 keni parashtruar kërkesë pranë Prokurorisë për pajisjen me përgjigje nga Arkivi Komunal, kopjen e kërkesës për ekspertizë grafologjike dhe deklaratën e noteres V.A., ju me datë 04.03.2024 keni nënshkruar fletkthesën e PTHP ku keni konfirmuar pajisjen me dëshmi të kërkuara. Po ashtu ju me datë 27.09.2024 keni parashtruar sërish kërkesë pranë Prokurorisë për pajisjen me shkresa të lëndës me që rast me datë 30.09.2024 , ju janë siguruar

dhe dorëzuar shtatë folldera me të gjitha shkresat e lëndës ju po ashtu keni nënshkruar flet kthesën e PTHP-së; me datë 01.10.2024. Përsëri av. S.K. përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar kërkesë për pajisjen e dokumentit saktësisht Kërkesës për ndihmë Juridike Ndërkombëtare Drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës dhe përgjigjen e të pranuar nga ILECU të cilës I janë dërguar komplet shkresat e kërkuara ku kanë qenë në mesin e tyre edhe deklarata e S.H., fakte ky që mund të provohet (dëshmi email zyrtar me dokumentacion të skanuar).

Ndërsa sa i përket pretendimeve tuaja se unë nuk paskam deponuar në gjykatë dy ekspertizat grafologjike, përgjigja e ILECU -të, përgjigja e arkivit nder komunal, edhe ky fakt nuk qëndron sepse po këto dëshmi dhe të gjetura janë prezantuar në ANKESËN e dorëzuar në Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për Gjykatën e Apelit me dt. 30.05.2024, dëshmi kjo që mund të vërtetohet dhe keni mundur që ta vërtetoni nëse keni dashur, dhe nuk e keni bërë këtë, pasi që jeni pajisur me TË GJITHA SHKRESAT E LËNDËS, e në qoftë se nuk e dispononi të njëjtën Ankesë mund të paraqitni kërkesë për tu pajisur dhe vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e juaja në asnjë mënyrë dhe në asnjë rrethanë.

Avokatja S.K., kërkesën e saj inicimin e procedurës disiplinore kundër meje të paraqitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë –Departamentit të Përgjithshëm, me datë 10.12.2024 e ka bërë në drejtim të pretendimeve të saja se:

- kinse unë nuk e kam cekur në Aktvendim për pushimin të Hetimeve njoftim nga autoritetet serbe me nr. të rastit ... të datës 21.05.2024 të dërguar përmes email adresës lidhur me kërkesën me nr. reference ku thuhet se autoritetet relevante në Ministrinë e Brendshme të Serbisë, kanë konstatuar se në arkivat e tyre nuk posedojnë dokumente të kërkuara nga Policia e Kosovë.

- Fillimisht këtë njoftim nuk e kam marrë si provë, pasi që Njoftimi në fjalë është dërguar nga policia e Qytetit të Kurshumlisë së shtetit të Serbisë, të cilin njoftim e ka nënshkruar një polic emrin e të cilit tani nuk e kujtoj, pa vulë dhe pa numër të protokollit, në të cilin njoftim polici në fjalë fare nuk ka treguar se i njëjti ka bërë ndonjë kërkesë me ndonjë datë të caktuar apo ka marrë ndonjë përgjigje adekuate nga persona zyrtarë të arkivave kadastrale të shtetit të Serbisë, për ta vërtetuar me ndonjë fakt se policia ka ndërmarr veprime në këtë drejtim, në institucionit adekuat gjegjësisht Kadastrit të Serbisë gjegjësisht arkivave të shtetit të Serbisë që gjenden në Beograd, por i njëjti me një njoftim të shkurt ka cekur vetëm se këto dokumente nuk gjenden në arkivat tona, pa specifikuar se në cilat Arkiva të policisë apo në arkivat e shtetit të Serbisë nuk gjenden dokumentet e kërkuara nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.

2. Avokatja S.K., në kërkesën e saj për inicimin e procedurës disiplinore kundër meje përsëri ka bërë shpifje kundër meje me pretendimet e saj të pabaza e tërësisht tendencioze, duke aluduar në bazën e të pavërtetave se kinse unë kam ndonjë lidhje miqësore me M.G, bashkëshorten e të pandehurit A.G. duke u përlurur edhe në këtë formë kinse përmes rrjetit social 'Facebook' citoj me fjalët e Av.S. K. S: ' në bazë të transmetimit të komenteve nga rrjeti social në Facebook nga llogaria e saj personale e quajtur N.S. kishte shprehur dashuri në foton të cilën gjendet bashkëshortja e A.G.t,

M.G një buçetë me lule në shenjë respekti dhe dashurie', nga këto të thëna të cilat janë qesharake dhe të pabaza, unë në atë foto në Facebook kam përshëndetur Doktoreshën E.D. tek e cila kam realizuar ekzaminime shëndetësore në atë periudhë gjegjësisht me datë 01.02.2021 për shkak të respektit ndaj saj (kjo mund të dëshmohet në këtë rrjet social) kur në këtë periudhë unë as që kam qenë në dijeni për këtë rast e as që jam ngarkuar me lëndën (data e ngarkimit të lëndës 14.10.2022), e që në rast konkret as nuk i kam njohur të apostrofuarat në foto!

3. Avokatja S.K, në kërkesën e saj për iniciimin e procedurës disiplinore kundër meje ka bashkangjitur një njoftim nga gjykata me të cilin gjyqtarja e procedurës paraprake është përgjigjur në kërkesën e Prokurorisë për bashkimin e lëndës në fjalë pasi që njëjta ka marr dy numra në gjykatë, unë nuk i kuptoj pretendimet e avokates në fjalë pasi që në prokurori ne kemi pasur vetëm një lëndë me një numër PP/II.nr..... ndërsa sa i përket gjykatës nuk është në domenin tonë ta obligojmë gjykatën se si të vendos në punën e saj.

I Nderuar Kryeprokuror, siç e dini edhe ju Aktvendimi për pushimin e hetimeve me nr. të rastit PP/II.nr..., kundër të pandehurit Y.H dhe A.G., në drejtim të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mashtrimi sipas nenit 323 par 4 lidhur me par 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i punuar nga ana ime ka qenë i përpiluar fillimisht në 30 faqe, e më pas sipas rekomandimeve nga ana e zyrës tuaj i njëjti Aktvendim është i shkurtuar në vëllim më të vogël, në të cilin aktvendim unë kam cekur të gjithë ecurinë e rastit në fjalë e që më pas të njëjtin e kam shkurtuar, dhe pas analizimit të njëjtit nga ana e juaj dhe pas nënshkrimit edhe të shënimit zyrtar unë i kam pushuar hetimet lidhur me rastin në fjalë. Andaj në këtë drejtim, unë si Prokurore që më parë kam qenë e ngarkuar me lëndën me nr. të rastit PP/II.nr..., kundër të pandehurve Y.H dhe A.G., në drejtim të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 395 par.1 të KPRK-së, si dhe veprës penale Mashtrimi sipas nenit 323 par.4 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, ju sigurojë që rastin konkret nuk kam bërë asnjë shkelje ligjore sa i përket punës sime dhe Kodit të Etikës dhe atë neni 6, par.2 pika 2.10 për përgjegjësi disiplinore të gjyqtareve dhe prokurorëve."

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se prokurorja N.S. nuk ka kryer shkelje disiplinore të sanksionuara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, edhe përkundër pretendimeve ankimore të paraqitura në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nga ana e av.B.A., av.F.Sh. dhe av.S.K, si përfaqësues të autorizuar të palëve të dëmtuara G.S. dhe N.S., në çështjen penale nën numrin PP/II.nr..., e cila çështje ka qenë në trajtim nga prokurorja N.S..

Autoriteti Kompetent ka ardhur deri te ky përfundim për faktin se dispozitat ligjore të cilat rrjedhin nga Ligji për Prokurorin e Shtetit (Ligji nr.08/L-167), respektivisht neni 8 ka përcaktuar qartë kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve, e që në pikën 1.7, përcaktohet kompetenca e prokurorit në marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale. Në këtë drejtim, një prokuror nuk mund të vihet në përgjegjësi disiplinore për shkak se ka pushuar hetimet në një çështje

penale, meqenëse vendimet e prokurorëve për të pushuar hetimet janë pjesë e kompetencave të tyre ligjore. Nëse pala e dëmtuar nuk pajtohet me vendimin për pushimin e hetimeve ka të drejtën e atakimit të këtij vendimi në Prokurorinë e Apelit, çka edhe realisht ka ndodhur dhe lënda është kthyer në rivendosje. Prokurorët gëzojnë pavarësi funksionale në marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Marrja e vendimeve, si pushimi i hetimeve është një veprim ligjor dhe profesional i bazuar në vlerësimin e fakteve dhe provave. Në anën tjetër, vlerësimi i provave është një proces profesional dhe subjektiv që bëhet në bazë të njohurive juridike dhe fakteve të paraqitura. Prokurori lidhur me çështjen që ka në trajtim, ka kompetencën e vlerësimit të provave në mënyrë të pavarur. Duhet kuptuar faktin se, vlerësimi i provave nuk është një proces matematikor dhe absolut, ai mund të ndryshoj nga një prokuror në tjetrin, andaj në këtë rast, prokurorja N.S. ka vepruar totalisht brenda diskrecionit të saj si prokuror e çështjes në lëndën PP/II.nr.....

Po ashtu, është në diskrecionin e prokurorit të çështjes të vendose se cilat prova janë relevante për rastin konkret dhe i gjithë ky proces i vlerësimit të provave bazohet në gjykimin profesional të prokurorit të çështjes, andaj si i tillë nuk mund të interpretohet si shkelje disiplinore.

Pretendimet se prokurorja ka komunikuar informacione konfidenciale me persona të paautorizuar, ky pretendim nuk është vërtetuar asnjëherë, respektivisht pretendimet e palës ankuese nuk gjejnë mbështetje në prova. Autoriteti kompetent nuk ka gjetur asnjë evidencë se prokurorja N.S. ka shpërndarë informacione konfidenciale në mënyrë të paautorizuar, ashtu siç pretendon pala ankuese, andaj këto pretendime mbeten të pambështetura në prova.

Sa i përket pretendimeve se prokurorja i kishte premtuar të pandehurit A.G. se nëse i dorëzon historiatin e pronës, ajo në mënyrë të kundërligjshme do t'i pushojë hetimet, as një pretendim i tillë nuk qëndron, është i pa mbështetur në prova dhe si i tillë është i pabazuar.

Pretendimet se të autorizuarit e palëve të dëmtuara nuk janë pajisur me shkresa të lëndës si dhe është tentuar që të fshihen prova nga të lartcekurit, theksojmë se nga shkresat e lëndës, respektivisht fletëkthesat e nënshkruara nga përfaqësuesja e të dëmtuarve, av.S.K por edhe nga komunikimet përmes postës elektronike vërtetohet se të autorizuarit e palëve të dëmtuara janë pajisur me shkresa të lëndës dhe çdo kërkesë e tyre është trajtuar nga prokurorja N.S., duke mos harruar të theksojmë edhe se lënda PP/II.nr.... është lëndë voluminoze, në total ka 15 foldera, andaj edhe harresa në pajisjen me ndonjë shkresë është tejet e kuptueshme, gjithmonë duke marrë për bazë se lënda është tejet voluminoze si dhe duke marrë për bazë ngarkesën me të cilën përballen prokurorët e Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore, meqenëse prokurorja N.S. nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim karshi njoftimit të gjyqtarës E.Q. për bashkim të lëndëve, theksojmë se Prokuroria nuk ka kompetencë të ndërhyjë në vendimet e gjykatës sa i përket bashkimit apo veçimit të një procedure. Prokuroria Themelore në Prishtinë është në trajtim të vetëm një lënde sa i përket kësaj çështje penale, respektivisht nga ana e prokurores N.S. asnjëherë nuk është bërë veçimi i procedurës, lënda në prokurori mban vetëm një numër dhe atë numrin PP/II.nr.....

Sa i përket pretendimit lidhur me arrestimin e të pandehurit A.G., theksojmë se pas arrestimit të të lartcekurit me dt.25.08.2023, të nesërmen me dt.26.08.2023 prokurorja N.S. kishte dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë kërkesën për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit A.G., e që e njëjta kërkesë ishte refuzuar me vendimin e gjykatës PPR.nr.... të dt.27.08.2023, duke ia caktuar të njëjtit masën e arrestit shtëpiak. Në seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit, prokurorja N.S. ka theksuar dhe elaboruar ekzistimin e të gjitha kushteve të nevojshme për caktimin e paraburgimit, konform nenit 184 të KPP-së, madje kundër aktvendimit për refuzim të kërkesës për caktim të paraburgimit me dt.29.08.2023 kishte ushtruar edhe ankesë pranë Gjykatës së Apelit të

Kosovës. Sa i përket pretendimeve mbi atë se çfarë është gjetur në shtëpinë e të pandehurit A.G., lidhur me rastin në fjalë është iniciuar procedurë e ndarë nga Policia e Kosovës me kallëzimin penal me numër, meqenëse rasti i tillë nuk kishte asnjë ndërlidhje me çështjen të cilën prokurorja N.S. kishte nën hetime.

Sa i përket çështjes se prokurorja nuk ka bërë kërkesë për vazhdimin e masës së arrestit shtëpiak ndaj të pandehurit A.G., theksojmë se masat e sigurisë përfshirë edhe arrestin shtëpiak, respektivisht kërkesat lidhur me caktimin apo vazhdimin e tyre janë të justifikuara vetëm kur plotësohen kushtet ligjore për to dhe nëse prokurori arrin në përfundim se këto kushte nuk plotësohen më, prokurori ka të drejtë të mos bëjë kërkesë për vazhdimin e masës për sigurimin e të pandehurit në procedurë. Ndëshkimi i një prokurori për ushtrimin e diskrecionit të tij/saj, do të cenonte pavarësinë dhe efektivitetin e punës së tij/saj, duke krijuar kulturë frike dhe pasigurie në sistemin e drejtësisë. Andaj, prokurori nuk mund të mbahet përgjegjës për mosparaqitjen e kërkesës për vazhdimin e arrestit shtëpiak, për sa kohë ky vendim është marrë në përputhje me diskrecionin e tij profesional dhe bazuar në rrethanat e çështjes.

Pretendimi se prokurorja N.S. ka raporte të ngushta shoqërore me bashkëshorten e të dyshuarit A.G., M.G dhe me noteren që e ka noterizuar dokumentin Resenje broj....., për dy të dyshuarit Y.H dhe A.G., nuk qëndron as një pretendim i tillë, kjo për faktin se prokurorja N.S. është e vërtetë se më 01.02.2021 kishte dërguar përmes llogarisë së saj në rrjetin social Facebook një buçetë me lule, por jo siç pretendon pala ankuese, meqenëse komenti nuk i ishte drejtuar të apostrofuarave nga pala ankuese, por i ishte drejtuar doktoreshës E.D. tek e cila prokurorja në fjalë kryen ekzaminime mjekësore, ndërkaq fotografia që ishte plasuar në rrjetet sociale nuk ishte plasuar as nga llogaria e M.G e as e noteres së lartpërmendur nga pala ankuese. Sidoqoftë, Kryeprokurori me të pranuar kërkesën e parashtruar nga përfaqësuesja e palëve të dëmtuara, av.S.K, për përjashtimin e prokurores N.S. nga trajtimi i kësaj çështje penale, të njëjtën kërkesë e ka aprovuar me Vendimin PP/II.nr.... të dt.01.11.2024, me të vetmin qëllim që të shmangen të gjitha dyshimet e palëve lidhur me objektivitetin dhe paanshmërinë e prokurorit të shtetit.

Sa i përket pretendimeve se prokurorja kishte kërkuar sekuestrimin vetëm për parcelën, duke ju sjellë dobi pasurore të dyshuarve, theksojmë se kërkesa e palëve të dëmtuara në kallëzimin e tyre penal ishte caktimi i masës së përkohshme të sigurisë për parcelën e që edhe aktvendimi për fillimin e fazës së hetimeve ishte në ndërlidhje me të njëjtën parcelë, andaj prokurorja N.S. më datë 26.05.2023, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte paraqitur kërkesë për urdhër ndalues përfundimtar, përmes së cilës ka kërkuar që të urdhërohet ndalimi /sekuestrimi i përkohshëm i parcelës ..., ZK Prishtinë, me ndryshimet e pësuarat e të cekura si në kërkesë.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se pretendimet e theksuara në Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore nuk paraqesin shkelje disiplinore, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar që veprimet e prokurores N.S. paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, neni 6, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, 2.4, 2.5 dhe 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

ZEJNULLAH GASHI

-Këshillit Prokurorial të Kosovës
-Arkivës